




01-1184



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-149291/23 dt. 19.07.2023, të pronarëve Gazmend, Arben, Bujar, dhe Leonard Qerkezi, Mustafë Halili, Gani Ademi, Ruzhdi dhe Agron Mejzinolli, Almin Uka, Beqir Kaqandolli, Eset, Ali dhe Ramadan Murati, Idriz dhe Feriz Zeka, Sylejan Zabeli nga Prishtina dhe investitorit “Model Sllovenia Invest” sh.p.k. me seli në Prishtinë, rruga “Sicilia”, Lagja Kalabri, Prishtinë, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për kompleksin e ndërtesave shumë banesore me afarizëm, ndërtuar në kuadër të bllokut urbanistik “C4”, të Planit Rregullues “Kalabria” dhe PZHU-së, në rrugën “Sicilia” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datë 12.04.2024, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET pronarëve Gazmend, Arben, Bujar, dhe Leonard Qerkezi, Mustafë Halili, Gani Ademi, Ruzhdi dhe Agron Mejzinolli, Almin Uka, Beqir Kaqandolli, Eset, Ali dhe Ramadan Murati, Idriz dhe Feriz Zeka, Sylejan Zabeli nga Prishtina me investitor “Model Sllovenia Invest” sh.p.k. me seli në Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit ARBK 810871021, me përfaqësues/pronar Afrim, Lulzim, Bajram, Ilir, dhe Bujar Tafa nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-149291/23 dt. 19.07.2023, përdorimi i kompleksit të ndërtesave shumë banesore me afarizëm, Lamelat “B1/6” & “B2/6” me etazhitet -B+2S+P+6ET+NK dhe “B3/6”, “B4/6”, “B5/6” & “B6/6” me etazhitet -2B+S+P+6ET+NK të ndërtuara sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-138974/18 dt. 09.08.2018, në kuadër të bllokut urban “C4”, të Planit Rregullues “Kalabria” dhe PZHU-së në Prishtinë konkretisht në parcelën kadastrale nr. 10219-0, ZK Prishtinë.

II. Ndërtesat nga pika I. e këtij vendimi, ndodhen në rrugët “Sicilia” dhe “Krusha e Madhe” ku kanë dalje hyrjet e këtyre ndërtesave me numrat: 41, 43, 45, 47, 49, 51, 53, 55, 57, 59, 61, 63, 65, 98, 100, 102, 104, 106, 108, 110, 112, 114, 116, 118, 120, 122, 124, 126, 128, 130, 132, 134, 136, 138, 140, 142 dhe 144 në Prishtinë, dhe të njëjtat do të përdoren dhe shfrytëzohen sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesave dhe njërive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

Ar sy e t i m

Pronarët Gazmend, Arben, Bujar, dhe Leonard Qerkezi, Mustafë Halili, Gani Ademi, Ruzhdi dhe Agron Mejzinolli, Almin Uka, Beqir Kaqandolli, Eset, Ali dhe Ramadan Murati, Idriz dhe Feriz Zeka, Sylejan Zabeli nga Prishtina dhe investitori "Model Sillovenia Invest" sh.p.k. me seli në Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit ARBK 810871021, me përfaqësues Afrim, Lulzim, Bajram, Ilir, dhe Bujar Tafa, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-149291/23 dt. 19.07.2023, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për kompleksin e ndërtesave shumë banesore me afarizëm, Lamelat "B1/6" & "B2/6" me etazhitet -B+2S+P+6ET+NK dhe "B3/6", "B4/6", "B5/6" & "B6/6" me etazhitet -2B+S+P+6ET+NK, të ndërtuara në kuadër të bllokut urban "C4", të Planit Rregullues "Kalabria", në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 10219-0, ZK Prishtinë, sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore Ndërtimore 05 Nr. 351/02-138974/18 dt. 09.08.2018, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Akt përcjellës", me referencë 09 Nr. 391/02-237042/22 dt. 17.05.2023, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Njoftimit mbi Inspektimit Final të punëve dhe përkrahimit të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikëqyrësi Driton Tefiku; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikëqyrësi Xhelal Hoxha; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikëqyrësi Kaltrina Tosuni Ahmetaj; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektrike, nga mbikëqyrësi Skender Rugovaj; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikëqyrësi Faton Behrami; Raportin e përfundimit të punëve për mbrojtje nga zjarri, nga Berat Hasanaj, Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga kompania e licencuar për matje gjeodezike "GES PLAN" me numër të licencës 46;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht kompleksi i ndërtesave shumë banesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e



certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim nr. 04/L-110, janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezantuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesat shumë banesore me afarizëm mund të përdoren, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesat shumë banesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certificate, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja

Ky vendim u printua në 6 (gjashtë) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuesve/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-149291/23 DT. 12.04.2024**

Zyrtari,
Berim Osmanaj

Udhëheqëse e Sëktorit,
Nazife Krasniqi



